



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE NGRITJE NË DETYRË NË KATEGORINË  
E MESME DREJTUESE**

**Lloji i diplomës “shkenca shoqërore/ shkenca ekonomike”**

**niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”**

Në zbatim të nenit 26 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive shpall procedurat për plotësimin e vendit të lirë të kategorisë së mesme drejtuese:

**- 1 (një) Drejtor në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë - Kategoria e pagës II-b**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë se ky pozicion është vakant, ai është i vlefshëm për nëpunësit civilë nga kategoria paraardhëse për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për çdo procedurë aplikohet në të njëjtën kohë!

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR LËVIZJE PARALELE: 16 Nëntor 2021

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR NGRITJE NË DETYRË: 22 Nëntor 2021

**Përshkrimi i punës:**

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Përcakton prioritetet, vendos objektiva, organizon dhe motivon stafin në përmbushjen e këtyre objektivave;
- Identifikon nevojat për ndryshim në planin e punës apo procese. Identifikon një numër zgjidhjesh dhe i vlerëson ato në raport me përmirësimin e rezultatit;
- Vendos marrëdhënie bashkëpunimi me përfaqësues të institucioneve/ partnerë/grupe interesi me qëllim krijimin e një mjedisi tepër bashkëpunues, këshillues dhe mbështetës për zbatimin e politikave të institucionit;
- Nxit dhe mbikëqyr zbatimin e detyrave ngarkuar sektorëve në varësi;
- Siguron që përdorimi i burimeve njerëzore të jetë në nivele të kënaqshme;
- Ruan marrëdhënie të mira bashkëpunimi me partner/grupe të interesit për realizimin e politikave të institucionit;
- Monitoron, ndjek dhe ndërhyr në realizimin e të gjithë politikave të personelit;

- h) Koordinon punën në bashkëpunim me drejtoritë e tjera në përgatitjen e materialeve të kërkuara nga institucionet përkatëse në lidhje me procesin e integritetit;
- i) Siguron realizimin e planit vjetor të rekrutimeve për institucionin. Ndjek zbatimin e Kodit të Punës, ligjit të shërbimit civil dhe akteve në zbatim të tij për rregullim e marrëdhënies juridike të punonjësve në institucion;
- j) Koordinon punën për realizimin me sukses të aplikimeve pranë donatorëve të ndryshëm të huaj apo vendas, me qëllim thithjen e fondeve për përmirësimin e ushtrimit të funksioneve të AMA-s, diktuar nga ligji 97/2013;
- k) Në kuadër të anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare (EPRA, MNRA, BRAF, ITU...) etj, koordinon punën në bashkëpunim me drejtoritë e tjera për raportimet që Autoriteti kryen;
- l) Sigurohet që institucioni të ketë programe të trajnimit në përputhje me nevojat e personelit të institucionit, duke bashkëpunuar ngushtësisht me Drejtoritë në AMA;
- m) Realizon në rolin e autoritetit përgjegjës për detyrat e ngarkuara nga ILDKPKI në kuadër të zbatimit të Ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave”, në lidhje me të gjithë dokumentacionin që ka të bëjë me deklarin dhe kontrollin e pasurisë;
- n) Nxit marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore si dhe me partnerët ndërkombëtarë në fushën e mediave;
- o) Monitoron punët për mbarëvajtjen e konferencave, seminareve, trajnimeve dhe takimeve, me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë;
- p) Monitoron punët për zhvillimin e negociatave për nënshkrimin e memorandumeve, protokolleve dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit bilateral dhe multilateral me institucionet dhe autoritetet vendase dhe të huaj;
- q) Koordinon procesin e kthimit të përgjigjeve në kohë në lidhje me kërkesat dhe ankesat që vijnë nga subjektet, institucionet apo publiku;

## I- Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

### I.1 - Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta:

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria II-b);
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- Të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” për “Shkenca Shoqërore/Ekonomike”. Edhe diploma e nivelit Bachelor të jetë e të njëjtës fushë.
- Të ketë njohuri të thella të gjuhës angleze dhe të një gjuhe tjetër të BE-së;
- Të ketë mbi 1 vit eksperiencë në nivel të mesëm drejtues;
- Të ketë përvojë pune në fushën e komunikimit;
- Të ketë aftësi për të ofruar drejtim profesional, për të menaxhuar, planifikuar, koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë dhe përdorimin e burimeve në dipozicion;

- Të ketë njohuri të mira për strukturat e BE-së dhe proceset integruese;
- Aftësi shumë të mira komunikimi prezantimi dhe analitike.

## **I.2 - Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit dokumentet si më poshtë:

- a) Kërkesë
- b) Jetëshkrim
- c) Fotokopje të diplomës;
- ç) Fotokopje të librezës së punës; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- dh) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- g) Vlerësimin e fundit në punë;
- gj) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- h) Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorinë përkatëse

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 16 Nëntor 2021.

## **I.3- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:**

Në datën 17 Nëntor 2021, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e mos kualifikimit.

## **I.4- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista:**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuri në lidhje me ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Njohuri në lidhje me Kodin e Procedurave Administrative, i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me ligjin nr. 9154, dt. 06.11.2003” Për arkivat” dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

- Njohuri në lidhje me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Njohuri në lidhje me ligjin nr.43/2016, “Për Marrëveshjet Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuritë në lidhje me procesin e integritetit evropian;
- Njohuri në lidhje me ligjin nr.9131, date 08.09.2003, “Për rregullat e etikes në administratën publike”;
- Njohuri në lidhje me ligjin nr .9049, date 10.4.2003 “Per deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe te disa nëpunësve publike”, i ndryshuar.

#### **I.5- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:**

Kandidatët do të vlerësohen për dokumentacionin, përkatësisht (20 pikë) përvojë pune, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse (10 pike), si dhe vlerësimet pozitive (10 pike). Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Legjislacionin e përmendur në pikën I.4;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

#### **I.6- Data e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit:**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti Mediave Audiovizive do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AMA-s. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

## **II- Ngritja në detyrë**

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

### **II.1-Kërkesat e përgjithshme**

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

- Niveli i diplomës duhet të jetë “Master Shkencor”. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” për “Shkenca Shoqërore/Ekonomike”. Edhe diploma e nivelit Bachelor të jetë e të njëjtës fushë;
- Të ketë njohuri të thella të gjuhës angleze dhe të një gjuhe tjetër të BE-së;
- Të ketë mbi 3 vjet eksperiencë pune në nivel të ulët drejtues;
- Të ketë përvojë pune në fushën e komunikimit;
- Të ketë aftësi për të ofruar drejtim profesional, për të menaxhuar, planifikuar, koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë dhe përdorimin e burimeve në dipozicion;
- Të ketë njohuri të mira për strukturat e BE-se dhe proceset integruese;
- Aftësi shumë të mira komunikimi prezantimi dhe analitike.

**II.2- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Autoritetit të Mediave Audiovizive si më poshtë:

- a) Kërkesë
- b) Jetëshkrim
- c) Fotokopje të diplomës;
- ç) Fotokopje të librezës së punës; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- dh) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- g) Vlerësimin e fundit nga eprorit direkt;
- gj) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 22 Nëntor 2021.

**II.3- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:**

Në datën 23 Nëntor 2021, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e pranimin nga jashtë shërbimit civil dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet konkursi.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimin në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e mos kualifikimit.

#### **II.4- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet konkursi:**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuri në lidhje me ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Njohuri në lidhje me Kodin e Procedurave Administrative, i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me ligjin nr. 9154, dt. 06.11.2003” Për arkivat” dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.
- Njohuri në lidhje me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Njohuri në lidhje me ligjin nr.43/2016, “Për Marrëveshjet Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuritë në lidhje me procesin e integritetit evropian;
- Njohuri në lidhje me ligjin nr.9131, date 08.09.2003, “Për rregullat e etikes në administratën publike;
- Njohuri në lidhje me ligjin nr. 9049, date 10.4.2003 “Per deklarimin dhe kontrollin e pasurive, te detyrimeve financiare te te zgjedhurve dhe te disa nëpunësve publike”, i ndryshuar.

#### **II.5 Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- Intervistën e strukturuar me gojë deri në 40 pikë;
- Dokumentacioni i dorëzuar deri në 20 pikë

#### **II.6 - Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në faqen elektronike të AMA-s dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së email).

Adresa: Autoriteti Mediave Audiovizive, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Tiranë